

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Valon Totaj – kryetar i kolegjit, Burim Shala e Lumni Sallauka – anëtar, në çështjen kontestimore të paditëses F.J., e vajzërisë O., nga fshati ... komuna e Prishtinës, të cilën e përfaqëson i autorizuari i saj av.M.N. nga Prishtina, kundër të paditurit H.J. nga fshati ... komuna e Prishtinës, të cilin e përfaqëson i autorizuari i tij av.A.L. nga Prishtina, për shkak të zgjidhjes së martesës me shkurorezim, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurit të parashtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.763/15, të datës 18.12.2017, në seancën e kolegjit, të mbajtur me datën 01.10.2018, mori këtë:

## **A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e të paditurit H.J. nga fshati ... komuna e Prishtinës, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.763/15, i datës 18.12.2017, **VËRTETOHET**.

### **A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar e ka aprovuar në tërësi kërkesëpadinë e paditëses F.J., mbiemri i vajzërisë O., nga fshati ... komuna e Prishtinës. Në pikën I të dispozitivit e ka zgjedhur martesën lidhur në mes të paditëses F.J., mbiemri i vajzërisë O. nga fshati ... komuna e Prishtinës dhe të paditurit H.J. nga fshati ... komuna e Prishtinës, e lidhur me datë 27.05.2011, pranë Zyrës së Gjendjes Civile në ... komuna e Prishtinës, sipas certifikatës së martesës M 01067384, e evidentuar me nr. reference 19 | 2011 RM | 19003 dhe numër rendor 23, në bazë të nenit 68 të LMMF-së të Kosovës. Në pikën II të dispozitivit e ka obliguar shërbimin e ofiqarisë në fshatin ... komuna e Prishtinës, që në afatin prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi të bëjë ndryshimin në librin amëz të të kurorëzuarve. Në pikën III të dispozitivit ka vendosur që secila palë i bartë shpenzimet e veta.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë i padituri përmes të autorizuarit të tij dhe atë për shkak të shkeljes të së drejtës materiale, të drejtës procedurale dhe vërtetimit të gabuar, përkundër dëshmime të ofruara të gjendjes faktike, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovoj ankesën si të bazuar dhe lëndën ta kthejë në rigjykim duke administruar provat dhe dëshmitë e propozuara nga palët ndërgjyqëse, sepse gjykata

është bazuar me dëshmi të ndalura, të pa argumentuara dhe të marrë një aktgjykim të drejtë dhe të pa kontestueshëm.

Paditësja nuk ka parashtruar përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore të të paditurit dhe pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 të LPK, gjeti se:

Ankesa e të paditurit është **e pabazuar**.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se palët ndërgjyqësore kanë lidhur martesë me datën 27.05.2011, pranë zyrës së gjendjes civile në fshatin ... komuna e Prishtinës, fakt ky i provuar përmes certifikatës së martesës me numër të referencës 19 | 2011 RM | 19003 dhe numër rendor 23, të datës 30.03.2015, të lëshuar nga zyra e gjendjes civile në fshatin ... komuna e Prishtinës. Nga kjo bashkësi martesore ata nuk kanë pasur fëmijë të përbashkët. Sipas gjykatës së shkallës së parë, në fillim të martesës raportet e tyre bashkëshortorë kanë qenë të mira, megjithatë me kalimin e kohës ka ardhur deri te çrregullimi serioz i raporteve të tyre martesore, në atë masë ku të njëjtit kanë pasur mosmarrëveshje të shumta në mes vete gjë që ka sjellë edhe tek gjendja faktike aktuale, ku si pasojë e kësaj palët e kanë shkëputur jetën e përbashkët martesore dhe jetojnë ndaraz nga njëri tjetri që nga viti 2015, ashtu që nga kjo kohë paditësja jeton tek prindërit e saj. Në arsyetim të aktgjykimit, tutje theksohet se se i padituri në përgjigje në padi e ka kundërshtuar zgjidhjen e martesës me arsyetimin se nuk është vullneti i palës paditëse për zgjedhjen e martesës por e njëjta është e detyruar nga ana e prindit të saj, babait për zgjedhjen e asaj martese.

Gjykata e shkallës së parë për vërtetimin e gjendjes faktike ka bërë administrimin e provave të propozuara të palëve ndërgjyqëse dhe duke u bazuar në këtë gjendje të vërtetuar faktike ka vendosur si në aktgjykimin e atakuar duke vlerësuar se janë plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara me nenin 69 pika 1 dhe 2 të Ligjit për Familjen të Kosovës (LFK), me të cilën janë paraparë shkaqet e shkurorëzimit. Vendimin mbi shpenzimet e ka nxjerrë në mbështetje të nenit 450 dhe 463 të LPK-së.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë e aprovon vlerësimin dhe qëndrimin juridik të Gjykatës Themelore Prishtinë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2 pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së, të cilat gjykata e shkallës së dytë, në bazë të nenit 194 të LPK-së, i heton dhe vlerëson sipas detyrës zyrtare.

Në rastin konkret gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë i ka zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore, drejtë dhe në mënyrë të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike, e cila nuk vihet në dyshim me asnjë pretendim ankimor të të paditurit dhe duke u bazuar në këtë gjendje të vërtetuar faktike, drejtë e ka zbatuar edhe të drejtën materiale, të cilën e heton sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 194 të LPK.

Në të vërtetë me provat e administruara në këtë procedurë, gjykata e shkallës së parë bindshëm dhe në mënyrë të sigurt ka vërtetuar se martesë ka humbur qëllimin dhe efektin e vetë për të cilën është lidhur, ku përderisa martesë lidhet në bazë të dashurisë, besnikërisë dhe vullnetit reciprok të bashkëshortëve, attribute këto të cilat në rastin konkret, në bazë provave të administruara në këtë procedurë, mungojnë për çka edhe ka humbur kuptimi i ekzistimit të kësaj martesë. Kështu që me të drejtë gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara me nenin 69 par. 1 dhe 2 të LFK-së, në të cilën dispozitë saktësisht janë përcaktuar shkaqet për shkurorezim për shkak të së cilave bashkëshorti mund të kërkojë zgjidhjen e martesës.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurit se në rastin konkret paditësja ka pasur presion prej prindit të saj, duke përdorur dhunë, kërcënim, kushtëzim, për çka vullneti i saj nuk është manifestuar lirshëm, sepse në bazë të shkresave të lëndës, ky pretendim i të paditurit nuk është provuar me asnjë provë të vetme. Përkundrazi, në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar në këtë procedurë, del se paditësja e ka manifestuar lirshëm dhe realisht vullnetin e saj, përkatësisht në rastin në fjalë ka theksuar se nuk është e pajtimit që martesë në fjalë të vazhdojë edhe më tutje ngase palët ndërgjyqëse nuk jetojnë bashkarisht që mbi një vit, fakt ky i pohuar edhe në vetë ankesën e të paditurit, për çka edhe martesë në fjalë e ka humbur kuptimin e vetë, për çka e njëjta nuk mund të ekzistoj si e tillë sepse në këtë mënyrë nuk arrihet qëllimi i martesës. Se paditësja ka deklaruar dhe manifestuar vullnetin e saj të lirë për prishje të martesës në mes saj dhe të paditurit, flet edhe raporti i Qendrës për Punë Sociale në Prishtinë, në të cilin udhëheqësi i rastit pranë kësaj Qendre, në pjesën përfundimtare të raportit të tentim pajtimit (anamnezës sociale), ka konstatuar se ai nuk ka vërejtur ndonjë element se paditësja F. është e kërcënuar apo e shantazhuar nga familja. Martesë është institucion i të drejtës familjare e cila krijohet, ka kuptim dhe ekziston vetëm nëse ekziston vullneti i dy palëve bashkëshortore, në të kundërtën ajo nuk ka kuptim e as që mund të ekzistoj. Prandaj në situatën konkrete të gjitha pretendimet ankimore të të paditurit, Gjykata e Apelit i konsideron të pa bazuara dhe të pa qëndrueshme ngase nuk kanë asnjë bazë e as që kanë mundur të provohen me prova konkrete.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 paragrafi 1 pika (d) e LPK-së.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**Ac.nr.2605/18, me datën 01.10.2018**

**Kryetari i Kolegjit – Gjyqtari,**  
**Valon Totaj**